



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Z È D H È N È S I

Njoftim për SHTYP

Tiranë 04/11/2019

Konferenca e audituesve të rinj starton Muajin e Hapur të KLSH-së për Qytetarët

Mbështetur në standardin ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, ISSAI 12, “Vlerat dhe dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit- të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve” dhe me qëllim njohjen më të plotë dhe të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së Institucionit nga qytetarët, si edhe në kuadër të transparencës dhe njohjes së ndërsjellë të punës mes Departamenteve të auditimit në institucion dhe në zbatim të Strategjisë së Komunikimit të Institucionit për periudhën 2017-2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit organizon **për herë të tretë Muajin e Hapur për Qytetarët, në datat 1 Nëntor - 5 dhjetor 2019.**

Ky aktivitet zyrtarisht do të fillojë me Konferencën e Audituesve të rinj të KLSH-së (YOUNG ALSAI) me temë kryesore “*Sfidat e Auditimit Publik në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE*”, e cila do të zhvillohet në datat 5-6 Nëntor në Tiranë. **Konferenca hapet në datën 5 nëntor, ora 09:00** në ambientet e Akademisë së Shkencave dhe në të do të marrin pjesë përfaqësues të Komisionit Europian : z.Raymond Hill, Team Leader ne Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit(DG Budget); z.Salvador Bertomeu Hernandez, DG Budget dhe z.Joop Vrolijk, Ekspert i Financave Publike dhe Auditimit të Jashtëm në BE.

Gjate këtij muaji, qytetarët që do të vizitojnë mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit do të mund të njihen me historikun dhe arritjet e institucionit në 94 vitet e ekzistencës se tij nëpërmjet mini-muzeut në Hollin qendror të KLSH, do të takohen me punonjës, auditues dhe ekspertë të ndryshëm të institucionit, për të marrë të gjithë informacionin që ata do të dëshirojnë të kenë, përfshirë edhe auditimet në proces.

Janë të ftuar të gjithë gazetarët të marrin pjesë në Konferencën YOUNG ALSAI, si edhe në të gjitha aktivitetet e organizuara nga KLSH përgjatë Muajit të Hapur. Detajet e programit të aktiviteteve sipas ditëve, gjenden në faqen zyrtare të KLSH-së (www.klsh.org.al).

Orari i vizitave për qytetarët gjate gjithë Muajit të Hapur në KLSH do të jetë çdo ditë nga ora 10.00-16.00.